



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:030885

Datë: 26.06.2018

Numri i dokumentit: 00069863

P.nr.25/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, me Gjyqtaren Sabaheta Kurteshi dhe sekretarja juridike Senida Nuri, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. K. nga fsh., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8, lidhur me par. 6 të Kodit Penal të R. së Kosovës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Prizren, PP.nr. 2859-5/17 të dt. 23.02.2018, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP- Prizren , për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt.26.06.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore – Departamenti I përgjithshëm në Prizren , PP.nr. 2859-5/17 të dt. 23.02.2018, dhe kjo gjykatë, jep këtë :

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të akuzuarit:

A. K., nga i ati A. dhe e ëma B. e gjinisë S., i lindur më datë..., në Dragash, ndersa me banim në fshatin ..., Komuna Dragash, i martuar, baba i dy fëmijëve, i pa punë, ka të kryer fakultetin, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit ... të lëshuar nga MPB-ja në Prishtinë.

Sepse:

Me datë 06.10.2017, rreth orës 10:00, në rrugën e fshatit.. KK Dragashit, i akuzuari duke drejtuar automjetin e markës Renault Megane me targa... ne kundërshtim me nenin 53 të

Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor nr. 05/L-088 të Kosovës , duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes me kushtet dhe rrethanat e rrugës, kur arrin në vendin kritik, nga pakujdesia godet këmbësorin të dëmtuarin fëmijën G. B. i cili merr, lëndime të rënda trupore, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në akt ekspertimin mjeko – ligjor të Dr. V. H. dhe Dr. F. D. me nr. ref. Pz-31/2017 të dt. 18.11.2017.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale të rrezikimit të trafikut publik, nga neni 378 par. 8 e lidhur me paragraf. 6 të KP-së.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 41,43,46,73, dhe nenit 378 par.8 lidhur me par. 6 të KPRK-së, si dhe nenit 495 të KPPK-së, të akuzuarin e,

GJYKON

ME **DENIM** me gjobë në shumë prej **250,00.-€ (dyqind e pesëdhjetë euro)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi -Urdhri ndëshkimor, në kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 49 par.4 të KPPK-së, do ti **zëvendësohet** me dënim burgimi me këtë aktgjykim, në kohëzgjatje prej **13 (trembëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20.-€ (njëzet euro)**.

I dëmtuari – G. B. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest te rregullt civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej **60,88.-€** (edhe atë në emër të kompensimit të ekspertit mjeko – ligjor 20,00 € dhe 40,88€ në emër të kompensimit të shpenzimeve të ekspertizës së komunikacionit) , në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-€**, si dhe shumën prej **30,00€** në emër të kompensimit të viktimit të krimit, e këtë në afat prej **15 ditësh** pasi që Aktgjykimi-Urdhri ndëshkimor të merr formë të prerë, në kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Prizren, ka ngrit Aktakuzën PP.nr.2859-5/17 të dt. 23.02.2018 , ndaj të akuzuarit A. K. nga fsh.Rr. Komuna Dragash, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Komfor nenit 493 te KPPK-së, PTH në Prizren, kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënimin përkatës

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së nenit 378 par. 8 lidhur me par.6 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesit e kësaj veprë penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë në 1 (një) vjet.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –se në Prizren , për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në diapozitiv të Aktgjykimit.

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:-Raporti fillestar I incidentit me numër të rastit 2017-GR-0816 të dt. 06.10.2017,-Raporti i oficerit me nr.2017-GR/0816 të dt. 12.10.2017,-Deklarata e të akuzuarit: A. K., e dhënë në Stacionin Policor në Prizren, me dt. 06.10.2017,-Raporti mjekësor i Qendrës Kryesore të mjekësisë familjare në Dragash me nr. të protokollit 11997 i dt.06.10.2017,Raporti mjekësor I Spitalit Rajonal “Emergjencia” në Prizren për të dëmtuarin G. B. me nr. Të protokollit 12006 dt. 06.10.2017, -Akt ekspertimi i ekspertit të komunikacionit rrugor Inxh.dip. P. Sh. të dt. 18.12.2017,-Akt ekspertimi i ekspertit mjeko –ligjor, në Prishtinë, Dr.F. D. dhe Dr. V. H. me numër të referencës 31/2017, të dt. 18.11.2017, si dhe foto dokumentacioni në shkresat e lëndës.

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPK-së në mënyrë që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform nenit 450 par.2 dhe pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Sa i përket pagimit të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, ky vendim u murr konform nenit 39 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e viktimave të krimit i cili ka hyrë në fuqi më datë 28.05.2015.

Me sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2018:030885, 26.06.2018

G j y q t a r i

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi, në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjyqtares të kësaj Gjykatë. Nëse i akuzuari nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.